



Priloz - Priljeno Me/Dana: 22.12.2020

Universiteti Publik "KADRI ZEKA" GJILAN		Nr. i organit	Mumi-Broj	Shtojcë Priloz	Vlera Vre
22-12-2020 GJILAN		05	529/20		Komuna e Vitisë
01/2297		DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT			
		VITI			

Duke qenë se në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan janë në funksion të plotë dy drejtime studimore në kuadër të Fakultetit të Edukimit (Arsimi Filior dhe Arsimi Parashkollor);

Duke qenë se Fakulteti i Edukimit ka një specifikë tëvecantë për profilizimin e studentëve, që ka të bëjë me mbajtjen e mësimit praktik nëpër institucione shkollore dhe ato parashkollore;

Duke qenë se në Fakultetin e Edukimit në të dy programet i vijojnë studimet edhe studentët nga komuna e Vitisë, e të cilët rrjedhimisht do të ishte me e favorshme për ta mbajtura e mësimit praktik në institucionet shkollore dhe parashkollore në komunën nga vijnë;

E konsiderojmë të nevojshme të lidhim këtë

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan
të përfaqësuar nga rektori, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosum

dhe

Drejtorisë Komunale të Arsimit në Viti
të përfaqësuar nga drejtori, z. Besri Aliu

Artikulli 1

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan (UKZ) si entitet i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, ka për qëllim të vendosë raporte bashkëpunimi dhe partneriteti me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Viti (DKA), për të siguruar përmbushjen e programit të Fakultetit të Edukimit, respektivisht pjesëprogramore përkthazi me komponentën e mësimit praktik, si dhe krijimin e lehtësive për mbajtjen e mësimit praktik për studentë që vijnë nga komuna e Vitisë.

Artikulli 2

Thelbi i kësaj marrëveshje nënkupton vënien në shërbim të resurseve profesionale të stafit mësimdhënës dhe të stafit udhëheqës të shkollave shkollore dhe të enteteve parashkollore, të cilat drejtohen nga DKA.

Artikulli 3

Bashkëpunimi do të nënkuptojë pranimin dhe sistemimin e studentëve, për kohë të caktuar, në institucione shkollore dhe parashkollore dhe paktimin e mësuesve/edukatorëve në rolin e mentorëve për studentë që e mbajnë praktikën, duke u bazuar në planin programor të Fakultetit të Edukimit, si dhe në Detacakun e mësimit praktik.

Neni 4

Duke e pasur parasysh që mësimi praktik është pjesë integrale dhe e detyrueshme e planprogramit të Fakultetit të Edukimit, interesi afatgjatë i UKZ-së, është që kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi dhe partneriteti të mos jetë e kufizuar, respektivisht, kjo marrëveshje të jetë efektive

për atë kohë sa do të ketë programe të akredituara të Fakultetit të Edukimit nga ana e Agjencisë së Akreditimit të Republikës së Kosovës.

Neni 5

UKZ merr përsipër dhe pajtohet të përmbush detyrimet si në vijim:

- 5.1. UKZ të sigurojë përvoja të praktikës së mësimdhënies të një cilësie të lartë;
- 5.2. UKZ pajtohet që koordinatori i mësimit praktik të bashkëpunojë ngushtë me DKA-në, drejtorët e shkollave dhe entete parashkollëre, si dhe mësuesit/edukatorët mentorë për të siguruar që shkollat dhe entet parashkollëre të jenë të informuara për politikën dhe procedurat e mësimit praktik.
- 5.3. UKZ pajtohet që të sigurojë që mësimdhënësit e Fakultetit të Edukimit do t'i mbikëqyrin studentet gjatë mbajtjes së mësimit praktik sipas politikave të mësimit praktik të parapara me Doracakun e mësimit praktik.
- 5.4. UKZ pajtohet të sigurojë që mësimdhënësit mbikëqyrës do të bashkëpunojnë ngushtë me mësimdhënësit dhe edukatorët mentorë, për të siguruar që ngritja profesionale e studentëve të jetë e udhëzuar dhe e mbikëqyruar sipas politikave të Fakultetit të Edukimit.

Neni 6

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vit merr përsipër dhe pajtohet të përmbush detyrimet si në vijim:

- 6.1. DKA pajtohet që të vë në dispozicion resurset njerëzore dhe resurset materiale që i ka nën menaxhim për studentët dhe mbikëqyrësit e tyre nga Fakulteti i Edukimit, me qëllim të realizimit të mësimit praktik të paraparë me skemën programore të Fakultetit të Edukimit;
- 6.2. DKA pajtohet që të vë në dispozicion, për t'i mësuar studentet drejtpërdrejt në klasë, të gjithë rrejtin e mësuesve/edukatorëve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit, si dhe ata që do të certifikohen në të ardhmen;
- 6.3. DKA pajtohet të sigurojë që drejtorët e shkollave dhe entete parashkollëre të tregojnë gatishmëri për t'i pranuar studentët e listuar në listat e certifikuar nga Fakulteti i Edukimit për të mbajtur mësimin praktik në institucionet që janë nën menaxhimin e tyre;
- 6.4. DKA pajtohet që të sigurojë që drejtorët e shkollave dhe entete parashkollëre të luajnë rolin përkrahës në ofrimin e mbështetjes rreth organizimit të mësimit praktik dhe të lehtësojnë bashkëpunimin e mësimdhënësve mbikëqyrës nga Fakulteti i Edukimit dhe mentorëve në shkollat dhe ente parashkollëre.

Neni 6

Marrëveshja hyri në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

Gjilan, më 22.12.2020

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRIZEKA", GJILAN

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Rektor

DREJTORIA E ARSIMIT NE VITI

Z. Basri Aliu

Drejtor